



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 82, datë 21.05.2025

PËR
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “CREDINS INVEST” SH.A.
DHE TË FONDIT TË PENSIONIT ME PJESËMARRJE TË HAPUR CREDINS
PENSION, ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 76/2023 DHE RREGULLOREVE NË
ZBATIM TË TIJ

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 202, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe neneve 62 dhe 63, të Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Credins Invest” sh.a.-shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Miratimin e përshtatshmërisë së fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur Credins Pension, me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 3. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI